

UNIVERSITETI “Eqrem Çabej” Gjirokastrë
RREGULLORE ERASMUS +
VETEM PER STUDENTET OUTGOING

Erasmus + është program i financuar nga Bashkimi Europian për fushat e arsimit, trajnimit, rinisë dhe sportit për periudhën 2014-2021. Programi bazohet në programet e mëparshme të BE-së (Tempus, Erasmus Mundus, Alfa, Edulink etj.) dhe ofron mundësi për mobilitetin e studentëve dhe stafit, si dhe projekte për ndërtimin e kapaciteteve. Ky program bazohet në parimin e lëvizshmërisë për stafin dhe studentët, shkëmbimin e praktikave më të mira midis institucioneve të arsimit të lartë dhe forcimin e lidhjeve ndërmjet arsimit dhe tregut të punës. Programi është përgatitur nga Komisioni Europian dhe po implementohet nga Agjensia Ekzekutive për Media dhe Kulturë Edukimi (EACEA), në Bruksel, Agjencitë Kombëtare të themeluara në çdo vend të programit si dhe Zyrat Kombëtare të Erasmus në vendet partnere si Shqipëria. Një nga veprimtaritë kryesore të Erasmus + është Key Action 1, e cila ka për qëllim të rrisë lëvizshmërinë për studentët dhe stafin akademik/administrativ gjatë periudhës së studimeve të tyre. Këto aktivitete synojnë nxitjen e njohurive ndërmjet studentëve dhe stafit përmes shkëmbimit të praktikave më të mira, përmirësimit të aftësive të gjuhëve të huaja dhe aftësive përshtatëse me kulturën evropiane.

Universiteti Eqrem Çabej është bërë pjesë e programit Erasmus në 2015, dhe vit pas viti shkëmben studentë dhe staf me universitetet e huaja partnere. Sektori i Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënieve me Jashtë Universiteti Eqrem Çabej është sektori përgjegjës për aplikimin, zbatimin, koordinimin dhe monitorimin e të gjithë mobiliteteve të studentëve dhe stafit. Mes Universiteti Eqrem Çabej dhe institucionit partner (Programme Country) nënshkruhet një marrëveshje e cila përcakton numrin e shkëmbimeve dhe fushat e studimeve për studentët /ekspertizës për stafin.

1. Pranimi i studentëve për shkëmbim studentor

Pjesë e shkëmbimeve mund të jenë studente të nivelit të parë të studimit (BA) dhe nivelit të dytë (MA). Megjithatë, për t'u bërë pjesë e programit Erasmus +, studentët e Diplomave Profesionale & Bachelor duhet të kenë përfunduar patjetër vitin e parë të studimeve, ndërsa studentët Master mund të kryejnë shkëmbim që në semestrin e parë të programit të studimit.

Përgjatë gjithë vitit akademik, Sektori i Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënieve me Jashtë shpall thirrjet për aplikime¹ për shkëmbime studentore. Thirrja përmban informacion rreth periudhës së shkëmbimit, universitetit pritës, fushës së studimit, dokumentacionit të kërkuar për aplikim si dhe informacion rreth lëndëve që ofrohen në Anglisht në universitetin pritës.

Dokumentacioni për aplikim

¹ Thirrja për aplikime gjendet në Aneks 1



Për të aplikuar për shkëmbim studentor, studentët duhet të dorëzojnë pranë Zyrës së Projekteve dokumentat si më poshtë:

1. CV Anglisht
2. Listë notash në Shqip
3. Letër Motivimi në Anglisht
4. Learning Agreement (tentative) ²

Për plotësimin e Learning Agreement në fazën e aplikimit (Tentative) dhe për çdo ndryshim të bërë më pas (During Mobility), studentët duhet të konsultohen me Përgjegjësin e Departamentit të tyre, i cili duhet t'i udhëzojë për përzgjedhjen e lëndëve dhe ekuivalentimin e lëndëve të ndjekura në universitetin pritës në përfundim të mobilitetit. Learning Agreement firmoset nga vetë studenti dhe nga Përgjegjësi i Departamentit.

Spektori i Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënieve me Jashtë shqyrton aplikimet e studentëve, dhe organizon një intervistë në Anglisht me secilin aplikant. Krijohet një Komision Vlerësimi prej 3 anëtarësh:

1. Zv Rektori Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënieve me Jashtë
2. Koordinator i Erasmus Plus
3. Staf Akademik

Intervistat zhvillohen në Anglisht dhe Komisioni përcakton studentët e nominuar në përputhje me numrin e mobiliteteve të mundshme për atë thirrje. Komisioni nënshkruan një protokoll vlerësimi ³ dhe nominimet së bashku me protokollin e vlerësimit i dërgohen zyrtarisht universitetit pritës, i cili jep vendimin final për pranimin ose jo të studentëve të nominuar.

Disa thirrje për aplikime janë të decentralizuara dhe disa të tjera jo, që domethënë se disa aplikime kalojnë dhe vlerësohen direkt nga universiteti pritës, disa thirrje kanë 1 fazë përzgjedhjeje dhe disa dy. Universiteti pritës gjithmonë rishikon nominimet.

Mbasi universiteti pritës merr një vendim, kontakton drejtpërdrejt me studentët fitues dhe u jep udhëzime për parapërgatitjen për shkëmbim studentor. Koordinator i Erasmus Plus në Universiteti Eqrem Çabej ndjek hap pas hapi dhe asiston studentët fitues për përgatitjen për shkëmbim studentor.

² Learning Agreement gjendet në Aneks 2

³ Protokollin e vlerësimit gjendet në Aneks 3



2. Kohëzgjatja e shkëmbimit studentor

Shkëmbimet studentore zgjasin 3 -6 muaj ose 2 semestra. Rregullorja e Erasmus + përcakton se studentët mund të kryejnë deri në 2 semestra shkëmbim studentor brenda 1 cikli studimesh.

Që në momentin e aplikimit studenti njihet me kohëzgjatjen e shkëmbimit, megjithatë studentët mund të aplikojnë dhe për zgjatje të mobilitetit. Megjithatë, përparësi ju jepet studenteve të cilët nuk kanë pasur eksperiencë të mëparshme Erasmus+.

3. Zhvillimi i shkëmbimit studentor

Shkëmbimi studentor ndahet në 3 etapa, të cilat janë të gjitha shumë të rëndësishme:

- Periudha para kryerjes së shkëmbimit (Before mobility)

Kjo etapë përkon me procesin parapërgatitor për shkëmbim: aplikimi pranë Sektori i Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënieve me Jashtë, finalizimi i Learning Agreement nën udhëzimin e përgjegjësit të departamentit, aplikimi për vizë studenti etj. Përpara fillimit të shkëmbimit studentor, studenti firmos Deklaratën e Përgjegjësisë⁴.

- Periudha gjatë kryerjes së shkëmbimit (During mobility)

Gjatë shkëmbimit studentor, studenti mund të bëjë ndryshime në Learning Agreement deri në 5 javë nga fillimi i shkëmbimit. Ndryshimet kryhen vetëm me miratimin e Dekanit ose Rektorit në Universitetin Eqrem Çabej si dhe reflektohen në dokumentin Learning Agreement, i cili duhet firmosur (Responsible person at Sending Institution).

- Periudha pas përfundimit të shkëmbimit (After mobility)

Mbas përfundimit të shkëmbimit, studentët duhet të sjellin në Universitetin Eqrem Çabej:

1. Listë notash zyrtare
2. Certifikatë pjesëmarrje
3. Silabus për të gjitha lëndët e ndjekura
4. Kërkese për njohje lëndësh
5. Deklaratë për vërtetësinë e të dhënave

Studenti duhet të dorëzojë 1 kopje të dokumentacionit të lartpërmendur tek Kordinatori i Marrëdhënieve me Jashtë, Universiteti Eqrem Çabej dhe nga 1 kopje te koordinatori i departamentit përkatës.

Kordinatori i Erasmus Plus plotëson Learning Agreement After Mobility, dokument i cili reflekton njohjen e mobilitetit nga Universiteti Eqrem Çabej.

⁴ Deklarata e Përgjegjësisë gjendet në Aneks 4



Përgjegjësi i Departamentit ku bën pjesë studenti kryen ekuivalentimin e lëndëve; lëndët e ekuivalentuara i reflektohen studentit në LMS dhe fishë notash.

Shënim:

- a- UNIVERSITETI Universiteti Eqrem Çabej njih të gjitha lëndët që studenti ndjek në universitetin pritës, por jo domosdoshmërisht të gjitha lëndët ekuivalentohen/përshtaten me programin e studimit të studentit në Universiteti Eqrem Çabej. Prandaj këshillohet bashkëpunim shumë i ngushtë me përgjegjësin e Departamentit përkatës gjatë përgatitjes së Learning Agreement (Before & After mobility).
- b- Lëndët e Universiteti Eqrem Çabej, të cilat studentit i mbeten pa frekuentuar, mund të ndiqen në përfundim të shkëmbimit më seanca të përqëndruara, gjithmonë me miratimin e Sekretarisë së Përgjithshme. Studenti mund të zhvillojë deri në 3 lëndë me seanca të përqëndruara. Të drejtën për ndjekjen e seancave të përqëndruara direkt pas përfundimit të mobilitetit e kanë studentët në prag diplomimi, ose që kanë mangësi kreditesh për kalimin në vitin pasardhës. Studentët e tjerë do mund t'i ndjekin lëndët rregullisht në vitin pasardhës.

Studentët të cilët kanë ndjekur lëndë në Erasmus, vlerësimi për të cilat është me sistemin kalon/nuk kalon do të konvertohet në notë, e cila do jetë e njëjtë me mesataren që studenti ka në momentin që bëhet njohja. Në rast se studenti nuk pranon një konvertim në baz të mesatares, atëherë lënda nuk do të njihet dhe studenti do të duhet të ndjekë lëndë sipas kurrikulës së programit në të cilin është regjistruar.

4. Vlerësimi i dijeve të fituara nga studentët

Vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit gjatë periudhës së shkëmbimit studentor përcaktohet nga universiteti pritës. Në përfundim të shkëmbimit, universiteti pritës pajis studentin me një listë notash zyrtare, e cila përmban vlerësimin total me pikë dhe shkronjë.

5. Frekuentimi

Studenti duhet të frekuentojë klasat në universitetin pritës në përputhje me rregulloren e tij. Nëpërmjet Certifikatës së Pjesëmarrjes që studenti dorëzon në Universiteti Eqrem Çabej, vërtetohet se studenti ka frekuentuar me sukses të gjitha klasat.

6. Detyrime si praktika & Diploma

Studentët të cilët kryejnë shkëmbim studentor gjatë semestrit të fundit të programit studimor (BA ose MA) duhet që të shlyejnë detyrimet për praktikën dhe diplomën me Universiteti Eqrem Çabej . Këto studentë mund të kryejnë praktikë në Universitetin pritës ose në ndonjë institucion në vendin pritës, dhe vetëm në rast se pajisen me vërtetim, Universiteti Eqrem Çabej mund ta njohë atë. Në të kundërt, studentët do duhet të ndjekin orët e praktikës në auditor me seanca të përqëndruara pas përfundimit të shkëmbimit studentor, dhe më pas të bëjnë mbrojtjen e saj në Universiteti Eqrem Çabej. Gjithashtu studentët duhet të ndjekin



seancat metodologjike të diplomës dhe të kryejnë mbrojtjen e diplomës / provimin përfundimtar në Universiteti Eqrem Çabej.

7. Pagesa

Studentët fitues të një shkëmbimi studentor bëhen automatikisht përfitues të një burse të plotë e cila akordohet nga Komisioni European. Në përfundim të mobilitetit, studentët mund të kryejnë seanca të përqëndruara për shlyerjen e mungesave pa pagesë, si dhe provime pa pagesë (veëm për lëndët e ndikuara nga mobiliteti Erasmus). Të drejtën për ndjekjen e seancave të përqëndruara e kanë studentët në prag diplomimi, ose që kanë mangësi kreditesh për kalimin në vitin pasardhës.

MARRËVESHTJET E DYFISHTA

Shkëmbim studentor në kuadër të një programi të dyfishtë "Double Degree"

Studentët e Universitetit Eqrem Çabej mund të bëhen pjesë e shkëmbimeve studentore 1 vjecare në kuadër të marrëveshjes që Universiteti Eqrem Çabej mund të ketë me një nga universitetet partnere. Studentët bëhen përfitues të dy diplomave të lëshuara nga të dy institucionet.

Përzgjedhja dhe ekuivalentimi i lëndëve të ndjekura në programin e dyfishtë funksionon si për cdo shkëmbim tjetër studentor Erasmus +. Përgjatë gjithë shkëmbimit studentor, studenti konsultohet dhe informon vazhdimisht Kordinatorin e Marrëdhënieve me Jashtë në Universitetin Eqrem Çabej për mbarëvajtjen e mobilitetit dhe Dekanin për ndryshim lëndësh.

Në rastin kur studenti ka zhvilluar mbrojtjen e Diplomës në Universitetin partner, kur nuk ka një marrëveshje që parashikon ndryshe, për efekt të përmbushjes së detyrimeve përmbyllëse në Universiteti Eqrem Çabej, Departamenti cakton një udhëheqës për punimin, i cili garanton se punimi respekton formatin e Diplomës sipas Rregullores së Universiteti Eqrem Çabej. Pasi përshtat Diplomën që ka punuar në Universitetin pritës, studenti zhvillon mbrojtjen e Diplomës përpara komisionit të ngritur në Departament. Studenti është i/e lirë të zgjedh gjuhën në të cilën dëshiron ta dorëzojë punimin. Mbrojtja e punimit përpara komisionit do të zhvillohet në gjuhën shqipe. Drejtuesi i Departamentit/Kryetari i Komisionit i prezanton anëtarëve të Komisionit faktin që studenti ka bërë mbrojtjen në institucionin partner, sikurse i komunikon edhe vlerësimin e marrë. Vlerësimi final është tanger i komisionit përpara së cilit studenti zhvillon mbrojtjen e diplomës.



Aneks 1

***Thirrje për aplikime për shkëmbim studentor në Universitetin

Universiteti _____ u ofron studentëve të Universitetit Eqrem Çabej në programin mundësinë për

shkëmbim studentor 5-mujor gjatë vitit akademik . Studentët fitues përfitojnë një semestër shkëmbimi falas, me kompensim mujor ____ Euro dhe ____ Euro kompensim të udhëtimit.

Fushat e studimit: _____

Periudha e mobilitetit: _____

Dokumentat e nevojshme për aplikim:

- ☐ CV (në gjuhën angleze)
- ☐ Kopje e mjetit të identifikimit (pasaportë)
- ☐ Listë notash (në Shqip)
- ☐ Learning Agreement (tentative)
- ☐ Dokumenta mbështetës (letër rekomandimi, certifikata etj) përbëjnë avantazh.

Ftojme të gjithë studentët të aplikojnë.

Për t'u njohur me fushat e studimit dhe universitetin klikoni në linkun më poshtë:

[Aplikimi kryhet me email në lseiti@uogj.edu.al](mailto:lseiti@uogj.edu.al)

Deadline:

Për t'ju ardhur në ndihmë studentëve të Universitetit Eqrem Çabej për një aplikim sa më të suksesshëm kontaktoni: **Luiz Seiti**

lseiti@uogj.edu.al

Universiteti Eqrem Çabej, çdo ditë orari 10.00- 16.00.

Suksese!



Aneks 2. Learning Agreement Template

Student	Last name(s)	First name(s)	Date of birth	Nationality	Sex (M/F)	Study cycle ⁸	Field of education ⁹
Sending Institution	Name	Faculty/Department	Erasmus code ¹⁰ (if applicable)	Address	Country	Contact person name ¹¹ ; email; phone	
	European University of Tirana		Tirana	Blv. Gjergj Fishta, Nd. 70, H.1, 1023	Tirana, Albania		
Receiving Institution	Name	Faculty/Department	Erasmus code (if applicable)	Address	Country	Contact person name; email; phone	

[illegible]

The level of language competence¹⁸ in _____ [indicate here the main language of instruction] that the student already has or agrees to acquire by the start of the study period is: A1 ☐ A2 ☐ B1 ☐ B2 ☐ C1 ☐ C2 ☐ Native speaker ☐

Table B Before the mobility	Recognition at the Sending Institution			
	Component code (if any)	Component title at the Sending Institution (as indicated in the course catalogue)	Semester [e.g. autumn/spring; term]	Number of ECTS credits (or equivalent) to be recognised by the Sending Institution
				Total: ~

Provisions applying if the student does not complete successfully some educational components: [\[web link to the relevant information\]](#)

Commitment

By signing this document, the student, the Sending Institution and the Receiving Institution confirm that they approve the Learning Agreement and that they will comply with all the arrangements agreed by all parties. Sending and Receiving Institutions undertake to apply all the principles of the Erasmus Charter for Higher Education relating to mobility for studies (or the principles agreed in the Inter-Institutional Agreement for institutions located in Partner Countries). The Sending Institution and the student should also commit to what is set out in the Erasmus+ grant agreement. The Receiving Institution confirms that the educational components listed in Table A are in line with its course catalogue and should be available to the student. The Sending Institution commits to recognise all the credits gained at the Receiving Institution for the successfully completed educational components and to count them towards the student's degree as described in Table B. Any exceptions to this rule are documented in an annex of this Learning Agreement and agreed by all parties. The student and the Receiving Institution will communicate to the Sending Institution any problems or changes regarding the study programme, responsible persons and/or study period.

Commitment	Name	Email	Position	Date	Signature
Student					
Responsible person* at the Sending Institution					
Responsible person at the Receiving Institution ^(ix)					



Total: ~



Transcript of Records and Recognition at the Sending Institution

Start and end dates of the study period: from [day/month/year] to [day/month/year]

Table D After the mobility	Component code (if any)	Title of recognised component at the Sending Institution (as indicated in the course catalogue)	Number of ECTS credits (or equivalent) recognised	Grades registered at the Sending Institution (if applicable)
Total: ~				



i **Nationality:** country to which the person belongs administratively and that issues the ID card and/or passport.

ii **Study cycle:** Short cycle (EQF level 5) / Bachelor or equivalent first cycle (EQF level 6) / Master or equivalent second cycle (EQF level 7) / Doctorate or equivalent third cycle (EQF level 8).

iii **Field of education:** The ISCED-F 2013 search tool available at <http://ec.europa.eu/education/tools/isced-fen.htm> should be used to find the ISCED 2013 detailed field of education and training that is closest to the subject of the degree to be awarded to the student by the Sending Institution.

iv **Erasmus code:** a unique identifier that every higher education institution that has been awarded with the Erasmus Charter for Higher Education (ECHE) receives. It is only applicable to higher education institutions located in Programme Countries.

v **Contact person:** person who provides a link for administrative information and who, depending on the structure of the higher education institution, may be the departmental coordinator or works at the international relations office or equivalent body within the institution.

vi An **"educational component"** is a self-contained and formal structured learning experience that features learning outcomes, credits and forms of assessment. Examples of educational components are: a course, module, seminar, laboratory work, practical work, preparation/research for a thesis, mobility window or free electives.

vii **Course catalogue:** detailed, user-friendly and up-to-date information on the institution's learning environment that should be available to students before the mobility period and throughout their studies to enable them to make the right choices and use their time most efficiently. The information concerns, for example, the qualifications offered, the learning, teaching and assessment procedures, the level of programmes, the individual educational components and the learning resources. The Course Catalogue should include the names of people to contact, with information about how, when and where to contact them.

viii **ECTS credits (or equivalent):** in countries where the "ECTS" system is not in place, in particular for institutions located in Partner Countries not participating in the Bologna process, "ECTS" needs to be replaced in the relevant tables by the name of the equivalent system that is used, and a web link to an explanation to the system should be added.

ix **Level of language competence:** a description of the European Language Levels (CEFR) is available at: <https://europass.cedefop.europa.eu/en/resources/european-language-levels-cefr>

x **Responsible person at the Sending Institution:** an academic who has the authority to approve the Learning Agreement, to exceptionally amend it when it is needed, as well as to guarantee full recognition of such programme on behalf of the responsible academic body. The name and email of the Responsible person must be filled in only in case it differs from that of the Contact person mentioned at the top of the document.

xi **Responsible person at the Receiving Institution:** the name and email of the Responsible person must be filled in only in case it differs from that of the Contact person mentioned at the top of the document.

xii **Reasons for exceptional changes to study programme abroad (choose an item number from the table below):**

<i>Reasons for deleting a component</i>	<i>Reason for adding a component</i>
1. Previously selected educational component is not available at the Receiving Institution	5. Substituting a deleted component
2. Component is in a different language than previously specified in the course catalogue	6. Extending the mobility period
3. Timetable conflict	7. Other (please specify)
4. Other (please specify)	



Aneks 4 . Deklarata e Përgjegjësisë

Gjirokaster,

//

Unë Inëshkruari/a _____, në cilësinë e studentit/es të UNIVERSITETIT EQREM ÇABEJ deklaroj se gjatë gjithë periudhës së shkëmbimit studentor Mundësuar nga Zyra Erasmus në UNIVERSITETI EQREM ÇABEJ, do të zbatoj me tyrimet që rrjedhin nga nënshkrimi i Grant Agreement dhe përfitimi i bursës si dhe e UNIVERSITETI EQREM ÇABEJ në çdo institucion publik ose privat ku do e përaëojë. nuk respektohen ertaktimet e ketij paragrafi atehere jam ne dijeni cie keto

si përgjegjë/e i/e imazhit të UNIVERSITETI EQREM ÇABEJ, do të ndërmarr çdo veprim të nevojshëm për ij. Për plotësimin dhe finaizimn e Learning Agreement

ndryshim në Learning Agreement do të miratohet nga Përgjegjësi i Dpartamentit dosur në dispozicion siabuset e lëndëve të zgjedhura. Do të aportoj periodikisht ment përkatës të UNIVERSITETI EQREM ÇABEJ, Koodinatorit Erasmus Plus në UNIVERSITETI EQREM ÇABEJ në kërkesat përkatëse

këtij pargrafi tëherë jam në dijeni që këto veprime oe mosveprime do të i shkelje e rëndë e akteve rregullatore të UNIVERSITETI EQREM ÇABEJ, dhe ndaj meje mund të merren masat e përcaktuara në Statut dhe Rregullore

dakord që gjatë gjithë perudhës së studimeve në UNIVERSITETI EQREM ÇABEJ por edhe mbas përfundimit UNIVERSITETI EQREM ÇABEJ të përdorë pa kundërshpërbllim emrin, imazhin dhe kontaktet e mia në çdo publikim

